



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr 107 Datë 31.10.08

Për ndryshim destinacioni të fondit prej 180 000 lekësh të miratuar për projektin “Ditët e Mios 2008” për t’u përdorur për Zhvillimin e Konferencës Shkencore Mbarëkombëtare “Nga Evëtarët e Naum Veqilharxhit tek Kongresi i Manastirit”.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët Për ndryshim destinacioni të fondit prej 180000 lekësh të miratuar për projektin “Ditët e Mios 2008” për t’u përdorur për Zhvillimin e Konferencës Shkencore Mbarëkombëtare “Nga Evëtarët e Naum Veqilharxhit tek Kongresi i Manastirit”, në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 pika “dh”, ligjit nr 9936 dt. 19.05.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2008”, Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008”, Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme “Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008”, si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të destinacionit të fondit prej 180 000 lekësh të miratuar për projektin “Ditët e Mios 2008” për t’u përdorur për zhvillimin e Konferencës Shkencore Mbarëkombëtare detajuar si më poshtë:

a. Akomodim për të ftuarit

20 persona x 2 netë x 2 000 lek= **80 000 lekë**

2 Dieta ushqimore për vendasit

10 persona x 2 ditë x 2 000 lekë= **40 000lekë**

3 Dieta ushqimore për të huajt

10 persona x 2 ditë x 3 000 lekë= **60 000lekë**

TOTAL: 180 000 lekë

2. Ky fond do te perballohet me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet 00 08250 05 Art 6020000 - 180.000 (Qendra
Ekonomike e Kultures "V. Mio")

Shtohet 00 01110 05 Art 6020000 + 180.000 (Bashkia)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët dhe Qendra Kulturore "Vangjush Mio"

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Raimonda NASE
Raimonda NASE